



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201602200/2

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Rekomandojmë marrjen e masave për planifikimin e zhvillimit të gjykimit të çështjes administrative me Nr.31025-05405-86-2015 akti datë 02.09.2015, të paditësit B. Z. nga Tirana.*

Drejtuar : **Z. KASTRIOT SELITA**
Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit

TIRANË

I nderuar zoti Kryetar,

Në ankesën e tij datë 07.11.2016, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi B. Z. nga Tirana ankohet për zvarritje të padrejta gjykimi pa shkaqe ligjore, dhe shkeljen e procedurave gjyqësore nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në lidhje me gjykimin e një çështje administrative kundra DRSSH Tiranë me objekt kundërshtim vendimi dhe detyrimin e palës së paditur për ta trajtuar atë me pension pleqërie nga data 23.09.2014.

Ankuesi B. Z. nga ana e tij na shkruan se dosja e tij gjyqësore është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë me dt.02.09.2015 dhe në bazë të shortit elektronik të hedhur është caktuar si Relatore Zj.Blerona HASA e cila deri tani nuk ka planifikuar akoma gjykimin e saj.

Ankuesi B. Z. shkruan se nga pala e paditur nuk i jepet padrejtësisht pension pleqërie në bazë të legjislacionit në fuqi dhe duke patur parasysh se ai është në gjendje shëndetësore të rëndë nga sëmundje tumorale pasi ka kryer dy operacione të vështira, dhe pa të ardhura të tjera ekonomike ka kërkuar ndihmën dhe ndërhyrjen e institucionit tonë për të rekomanduar shpejtimin e procedurave gjyqësore.

Në rastin konkret ashtu siç përcaktohet edhe në nenin 3 të ligjit me nr.49/2012 ndër parimet e gjykimit administrativ ka përcaktuar sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve sa më të shpejta e të arsyeshme. Ky ka qënë edhe qëllimi i ligjvënësit me rastin e krijimit të këtyre gjykatave. Ligji synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, dhe se qëllimi i krijimit të gjykatave administrative është garantimi i mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe intersave të ligjshme të personave, ndërmjet një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta e të arsyeshme.

Afatet ligjore të përcaktuara në nenin 48 të Ligjit nr.49/2012 ku thuhet se Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve, nga data e ardhjes së ankimit nga Gjykata ku është paraqitur ankimi ka vend për tu respektuar nga ana juaj.

Ky qëndrim mbahet edhe nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë me vendimin e saj me Nr.81/2015.

Në këto kushte dhe duke u bazuar në kërkesat e nenit 63/3 të Kushtetutës së RSH ku thuhet se:”Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrata publike”. dhe të nenit 21/c të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se pas përfundimit të hetimit Avokati i Popullit, paraqet rekomandime për marrjen e masave për vënien në vend të së drejtës së shkelur, tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen.

Në këto rrethana mendojmë t’u,

REKOMANDOJMË :

1.Marrjen e masave ligjore për planifikimin e shpejtimin e gjykimit të çështjes administrative dt.02.09.2015 të paditësit B. Z. kundra DRSSH Tiranë, në të ardhmen

2.Mbi shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe masat e marra nga ana juaj, lutemi të njoftohemi me shkrim brenda 30 ditësh.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI